

# KOSOVARJA

Ballina: Arbnore Gegollaj

Çka ka bërë  
Qeveria  
për shqiptarët  
në Veri të Kosovës

Kush po i ndërron  
partitë si këmishat

A janë shqiptarët  
të moralshëm

## ARBNORE GEGOLLAJ,

YLLI I FUSHËS SË BUKURISË  
DHE ESTETIKËS,  
RRËFEN PËR RRUGËN E SUKSESIT



Beqarët  
e estradës

**Shkëndije Pacolli:**

Sëmundjet mendore  
janë më të zakonshme  
se kanceri!

Gruaja e la foshnjën  
në taksì e vetë iku

Burrin  
ma ka bërë  
Zoti dreq





 **MADE IN ITALY**

NE 31

120x240cm

JW 04

120x240cm

JW 17

120x278cm



**20%**  
**ZBRITJE**

[www.dino-company.com](http://www.dino-company.com)



*Syri i fotoreporterit*

# Fotografia që e trishtoi fotoreporterin amerikan

*Fotoreporterit i gazetës “New York Times” bëri me dije se fotografia më të dhimbshme e luftës që e shkrepri në Kosovë ishte e vajzës 7 vjeçe, Donjeta Deliu, nga Abria e Drenasit.*

23 anëtarë të familjes Deliu nga Abria e Drenasit u vranë e u masakruan nga forcat serbe 25 vjet më parë. E, në mesin e tyre ishte edhe Donjeta Deliu, 7 vjeçe.

Ajo kishte mbetur e vdekur në vendin “Zabeli i Rrajve”.

Atë e fotografoi fotografi i “New York Times”, Wade Goddard.

Motra e saj e vogël ishte ulur në bartësen e drurit afër saj, para se t’i largonin nga aty.

“Isha i tmerruar nga brutaliteti dhe, të jem i sinqertë, më nuk mund të bëja fotografi. Këtë herë isha i trishtuar. Kjo ishte më e rënda për mua gjatë qëndrimit në Kosovë”, tha ditë më parë ai

për Televizionin “Tëvë1”.

Ai si fotoreporter mori pjesë edhe në luftën e Kroacisë e të Bosnjës, por fotografia e shkrepur në Abri të Drenasit ishte momenti më i rëndë në jetën e tij.

“Kur arritëm në vendngjarje, pamë disa njerëz teksa i bartnin kufomat nga fusha pranë fshatit.

Ata bën bartës prej druri që t’i bartnin kufomat.

Ne ecëm përgjatë pyllit dhe pamë një tendë ku qëndronin të vranët. Një foshnjë ishte qëlluar në kokë”.

Ishte një moment i tmerrshëm t’i shihje fëmijët e vogël që ishin përpjekur të largoheshin përmes pyllit, teksa

ishin përndjekur nga njerëz të armatosur që qëllonin mbi ta”, thotë ai.

Në këtë masakër, u vra edhe motra e Donjetës, Gentiana, tetë vjeçe. Në mesin e të vranëve ishte edhe foshnja 6 javësh, Diturie Deliu.

Ai gjatë qëndrimit në Kosovë e kishte takuar vetë komandantin legjendar, Adem Jasharin.

“Erdha në Kosovë në shkurt të vitit 1998 dhe në terrenin e parë në Kosovë si gazetar takova Adem Jasharin, pastaj pas disa muajve e takova përsëri, por tani nën një strehë dhe i qëlluar me shumë plumba, së bashku me familjen e tij të gjerë”, shprehet ai.

# Çka ka bërë Qeveria për shqiptarët në Veri të Kosovës?

*Ali Kadriu e ka vënë flamurin kombëtar kuqezi mbi kulm të kullës së tij, në shenjë rezistence të banorëve shqiptarë në Lagjen "Kroi i Vitakut", në pjesën veriore të Mitrovicës, në kohën kur e vizituam në shtëpinë e tij, në prill të vitit 2015. Ai është bërë simbol paqeje dhe rezistence në këtë lagje, duke ngulur këmbë se prej aty del vetëm kur ta nxjerrin të vdekur. I rrahur disa herë prej serbëve, ai fajëson qeverinë e Kosovës se nuk ka bërë asgjë për qëndrimin e shqiptarëve në këtë pjesë të Kosovës...*

Serbë e shqiptarë në Lagjen "Kroi i Vitakut" në Mitrovicën Veriore, andej lumit Ibër, sikur garojnë se kush do të pushtojë më shumë tokën e pronave me origjinë shqiptare. Megjithatë, dallimet janë të

mëdha: Mëhallë-mëhallë shqiptarë e serbë kanë ndërtuar në brigjet kodrinore të Vitakut, pa llogaritur në fqinjësi dhe duke kaluar heshtazi pranë njëri-tjetrit, pa mirëmëngjes e pa mirëdita fqinjësore. Në këtë betejë ndëretnike, Beogradi ka qenë më luftarak, duke u dal në krahë serbëve, e që dihet e nuk dihet kush janë dhe prej nga vijnë.

Ndërsa, shqiptarët, në mungesë kujdesi të qeverisë së Kosovës, nuk kanë mundur të ndërtojnë as në trojet e tyre, ku u janë djegur shtëpitë gjatë luftës.

Andej lbrit për në Lagjen "Kroi i Vitakut" nuk ka kalimtarë rasti, pos nëse e humb ndokush rrugën. Të gjithë dinë ku shkojnë e për ata që janë vetëm, zakonisht, taksitë marrin rolin e bartësit.

Me të parë shtëpitë, dihet e cilës palë është: shtëpitë e vjetra dhe që kanë kulm tjegullash të vjetra janë të serbëve, ndërsa ato që kanë kulm të ri dhe me fasadë, janë të shqiptarëve, sepse janë ndërtuar pas luftime, meqë shtëpitë e paraluftës u janë djegur nga serbët.

Shqiptarët janë rrahur, vrrarë e maltretuar, duke punuar në trojet e veta. Pra, të pambrojtur nga askush.

Ndërsa, superioriteti serb, i përkrahur nga qeveria e Serbisë dhe UNMIK-u, i kanë penguar shqiptarët të kthehen aty. Një luftë të tillë ndërtimi tash, së voni, ka shënuar hapa të dukshëm favoritët nga serbët, të cilëve Serbia u ka ndërtuar objekte kolektive banesore, banorët e të cilëve nuk i ka parë askush më parë, e të cilët mendohet se janë serbë të ardhur

nga Kroacia e Bosnja. Dyshohen të jenë pjesëtarë të MUP-it të Serbisë. Posa të hysh në Lagjen "Kroi i Vitakut", syri të zë vetura pa tabela regjistrimi, e që ta kujton se je në një hapësirë ku nuk ka ligj, apo ku ligjin e dikton më i forti, sipas qejfit të vet.

Aty-këtu, kalimthi, në "Lagjen e Doktorëve", ndokush ndërton diçka në oborr a pastron oborrin...

## ALI KADRIU - SIMBOL I SHQIPTARËVE NË LAGJEN "KROI I VITAKUT"

Ali Kadriu i shpjegonte ekipit të revistës sonë, "Kosovarja", për peripecitë e shqiptarëve që të kthehen në shtëpitë e tyre. Ai tregonte me dorë se kah janë serbët e kah shqiptarët, pa u pasur frikë grupeve serbe që bënin lëvizje si banorë të banesave kolektive, para të cilave shumica absolute e veturave janë pa tabela regjistrimi.

Ali Kadriu, vëllai i dëshmorit dhe krijuesit poetik e të pikturës, Kadri Kadriu, që u masakrua nga serbët në mars të vitit 1999, thotë se, po qe se ne, shqiptarët, qarkullojmë me vetura pa tabela, menjëherë policia reagon, ndërsa serbët nuk i ndalë askush me tabela e pa tabela...

"Po e shihni edhe vetë se sa vetura qarkullojnë pa tabela regjistrimi! Nëse shqiptarët do të qarkullonin pa tabela menjëherë do të ndaleshin. E, ata nuk i

prekë askush.

Sa e sa vetura janë të parkuara para bane-save kolektive. Asnjë prej serbëve që janë në to nuk i kemi njohur.

E, unë jetoj këtu prej vitit 1987, pra qe gati 30 vjet dhe të gjithë ata serbë që ishin para lufte në këtë pjesë i kam njohur.

Këta që janë tash askush nuk e di prej nga i kanë sjell apo kush janë...

Dyshojmë se janë serbë të Kroacisë që i kanë humbur atje mundësitë e jetesës pas luftës me kroatët a nga Bosnja.

Por, sidoqoftë, këtu po i vendosë Serbia dhe qeveria e Beogradit", thotë Ali Kadriu në bisedën tonë.

## NUK E KEMI PËRKRAHJEN E QEVERISË SONË

"Qeveria e Serbisë u ka qëndruar afër serbëve, duke u dal krah për çdo problem dhe duke i mbështetur me forcat e MUP-it . U ka ndërtuar edhe banesa kolektive dhe duke e populluar Lagjen "Kroi i Vitakut" me banorë të rinj serbë, i përngjan kolonizimit të vjetër të Kosovës.

E, neve, shqiptarëve, nuk na ka dal në ndihmë qeveria e Kosovës, prandaj kemi mbetur nën mëshirën e fatit. Jemi duke bërë aq sa po mundemi vetë, sipas vendosmërisë sonë. Jemi duke jetuar në mesin e serbëve që nuk dimë se kush janë e nga i sjellë këtu Beogradi.

Realiteti ynë është i hidhur: Nuk e kemi përkrahjen e qeverisë sonë dhe askush deri më tani nuk na ka mbështetur me kurajo qeveritare, duke na lënë afër fuqinë policore të shtetit, jo për ta nënshtuar dikë këtu, por për ta mbajtur rendin ligjor dhe duke verifikuar se kush po vendoset këtu, kush po bëhet banor i Lagjes "Kroi i Vitakut".

Andaj, duke mos e pasur përkrahjen e qeverisë sonë, sot serbët po e popullojnë lagjen pa asnjë dokument identiteti, ndërsa ne, shqiptarët, që i kemi pronat dhe trojet tona, nuk mund të ndërtojmë, sepse kontestohemi nga komuna veriore, e udhëhequr nga Rakiqi", tregon tutje Ali Kadriu, në shtëpinë e tij.

## EDHE PSE I RRAHUR DISA HERË NGA SERBËT, NUK E LËSHON SHTËPINË...

Ali Kadriu, mbi kullën e tij, e që ndodhet në pikën më të lartë të kodrës së Vitakut, ka vënë flamurin kombëtar. Tregon peripecitë e ndërtimit të shtëpisë së tij dhe të familjes së vëllait të masakruar, Kadri Kadriut.

Thotë se është rrahur disa herë nga serbët, por prej shtëpisë nuk largohet dot...

Dhe, duke shpalosur këto detaje, thotë:

"Mua më kanë rrahur disa herë serbët dhe qëllimi i tyre ka qenë i qartë: të frikësohem dhe të largohem prej këtu.

Por, unë do të dal prej shtëpisë sime vetëm i vdekur! Ndryshe jo. Do ta mbroj pragun e shtëpisë sime, me çka do që mundem nëse sulmohem.

Ishte para një kohe te ne një delegacion shqiptar, bashkë me koordinatoren Ylber Hysa. Dhe, kur serbët hetuan se ishte delegacioni, na gjuajtën. Pjesëtarët e delegacionit ikën. Vetëm Ylber Hysa nuk iku. Qëndroi me mua. Ishte trim...

Andaj, duhet të kemi aso njerëz që dinë dhe që kanë një qëllim e ideal, se kombi nuk mbahet duke ikur.

Kam pasur presione të shumta për ta lëshuar shtëpinë dhe më janë ofruar edhe grupe të serbëve që kur e kanë parë se nuk po frikësohem fizikisht, më kanë ofruar blerjen e truallit.

Për 12 ari truall më kanë ofruar 1 milion e 200 mijë euro, por unë u kam thënë në sy se Serbia nuk ka para të ma paguaj shtëpinë e as tokën time...

Por, ndryshe prej meje, kanë vepruar shumë shqiptarë, të cilët i kanë shitur trojet dhe pronat, sepse për të qëndruar këtu nuk është dashur vetëm të jetosh, por edhe ta mbrosh idealin kombëtar e kulturor, sepse kultura është shpirti i një populli.

Shumë shqiptarë i kanë shitur pronat e tyre dhe tash gjendja është barazuar, gati 50 me 50.

Epërsia është në faktin se Serbia po u ndërton banesa kolektive serbëve me të madhe, ndërsa ne as që e hetojmë se ka qeveri të Kosovës në këtë pjesë.

Prandaj, them haptazi: askush për ne nuk ka bërë asgjë. Ata, të tanët, vijnë këtu vetëm për të kërkuar votat e shqiptarëve! Në mungesë të organizimit shtetëror nuk kanë ditur as të konkurrojnë si këshilltarë komunalë me një parti që do ta merrnin shumicën e komunës, por kanë garuar me disa parti, kështu që është shpërndarë vota shqiptare.

Andaj, në asamblenë komunale nuk kemi fuqi vendimmarrëse.

Sikur ta kishim pasur një qeveri aktive këndeje, me siguri, gjendja do të ishte ndryshe. Së pakut, do të kishim qëndruar të gjithë këtu e jo t'i kemi sot nja 30 shtëpi shqiptare në këtë pjesë dhe të mbesim nën pritjen e ardhjes së familjeve të tjera shqiptare që të kthehen këtu.

Më poshtë shtëpisë sime, të gjitha janë shtëpi shqiptare. Më poshtë është shtëpia e Bajram Rexhepit dhe ai vjen po kësaj rruge kah kaloj edhe unë.

Me keqardhje them se qeveria jonë i ka ndal edhe ndihmat sociale për shumë banorë që jetojnë këndeje, ndërsa Beogradi u jep sa mundet dhe u ndërton falas, duke

i stimuluar të vijnë këtu sa më shumë serbë...

Ka shtëpi serbe në këtë pjesë që dihet se mbajnë armë dhe armatim dhe këtë gjë e dinë botërisht të gjitha organet e sigurisë, por askush nuk ka ndërmarr asgjë që të vihen serbët nën ligj", ka pohuar për ekipin tonë në kullën e vet Ali Kadriu.

## KFOR-I FRANCEZ DHE SHQIPTARËT NË VERI

Ali Kadriu e ka bërë KFOR-in francez përgjegjës për mungesë sigurie në veri të vendit. Ai ka thënë se qysh në fillim të hyrjes së këtyre trupave ushtarake franceze, shqiptarët u privuan nga e drejta e jetës së lirë në shtëpitë e tyre.

Serbët, sipas tij, kanë gëzuar dhe gëzojnë të drejta edhe për kriminalitet, edhe për qarkullim të lirë në këtë pjesë, me e pa targa regjistrimi, ndërsa shqiptarët nuk e kanë të drejtën as të ndërtojnë në pronat e tyre!

"Qeveritarët tanë e përmendin veriun e vendit vetëm për poena politikë! Nuk jam që serbët të mos ndërtojnë në pronat e tyre, ata që i kanë pasur, por jam kundër ndërtimit pa asnjë lloj leje në pronat shqiptare.

Madje, na pengojnë gjatë ndërtimit, duke na gjuajtur me gurë... Ua kam bërë të qarët se nuk dal prej këtu, prej shtëpisë sime, pos kur të vdes.

Andaj, ndash le të gjuajnë, ndash le t'më rrahin...

E kam ndërtuar kullën, madje, në mënyrë simbolike. I ka 80 frenxhi. Në simbolikë të 11 Marsit i ka 11 frenxhi, të 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit tonë kombëtar, e që po valon mbi kullën time - 28 frenxhi, pastaj janë shtatë ditët e javës, e kështu me radhë...", thotë ai.

## NË VEND TË PËRFUNDIMIT

Kishte çka të shkruhet e për çka të shkruhet edhe shumëçka për jetën e përditshmërinë e shqiptarëve tashmë të quajtur të "Veriut të Mitrovicës", të cilët po harrohen nga pushtetarët tanë, veç ditëve të fushatave të zgjedhjeve kur edhe u premtojnë: Çështja e veriut do të zgjidhet shumë shpejt!

Edhe sa ditë, muaj, vjet do të fliten këto fjalë dhe këto premtime, të cilat asnjëherë nuk po ndërrojnë?

**Gani Dili  
Safet Krivaça**

**P. S.**

**Po e ribotojmë këtë shkrim me rastin e sulmit që bëri ditë më parë grupi terrorist nga Serbia në Banjskë të Zveçanit, e ku u vra polici i Kosovës Afrim Bunjaku.**

# I ndërrojnë partitë si këmishat!

*Përderisa ndonjërit prej politikanëve kosovarë ndërrimi i partive u ka sjellë beneficione dhe pozitë të mirë, disa nuk kanë arritur askund të rehatohen dhe ikja nga partia e parë ka qenë “vetëvrasje” politike. Shembuj të tillë në politikën kosovare ka me bollëk. Por, me këtë rast, po i zëmë në gojë vetëm disa sish që ende janë aktivë në politikë...*



## HYDAJET HYSENI NË LPK, LDK, LBD, PDK, VV

Hydajet Hyseni, më 1981, si organizatori kryesor i demonstratave, u burgos nga regjimi i kohës dhe i mbajti disa vjet burg të rëndë.

Por, pas jetës në burg, në vitet 90, qe kyçur në LPK, Lëvizje e cila vepronte në ilegalitet.

Pastaj, kalon në LDK-së, ku edhe arriti të bëhet nënkryetar i saj.

Pas lufte kaloi në LBD të Rexhep Qosjës, ku edhe aty ishte nënkryetar, por edhe aty nuk u rehatua.

Më vonë rreshtohet në PDK, por edhe në këtë parti nuk qëndroi gjatë dhe kaloi në “Vetëvendosje”, ku ende është aktiv në cilësinë e deputetit.

## MIMOZA KUSARI-LILA, ZËVENDËSKRYEMINIS- TRE, MINISTRE, NËNKRYETARE E AKR-së, KRYETARE E “ALTERNATIVËS”

Përgjatë viteve ka mbajtur poste të rëndësishme në jetën politike.

Mimoza Kusari-Lila karrierën e saj politike e nisi këshilltare e ish-kryeministrit Bajram Rexhepi në vitin 2003.

Nga aty Kusari-Lila ka vazhduar për të mbajtur postin e zëvendëskryeminitres dhe të ministres së Tregtisë dhe të Industrisë së Republikës së Kosovës. Më pas, nën logon e AKR-së, fitoi besimin e qytetarëve të Gjakovës për të qenë udhëheqësja e tyre.

Ndërkohë publikoi subjektin e saj politik “Alternativa” dhe qe dy palë zgjedhje kandidon nën listën e Lëvizjes “Vetëvendosje”, e që si shpërblim mori pozitën - shefe e grupit parlamentar të “Vetëvendosjes”, ku ndodhet edhe tash.



## DONIKA KADAJ-BUJUPI NË AAK, VV, PËRSËRI NË AAK

Elegante, me zë të butë, flokëkaqurrele, Donika Kada-Bujupi, nga zëdhënëse e KEK-ut, u bë editore e Agjencisë së lajmeve “Kosovanews” dhe në popull identifikohet më shumë si “Agjencia e Donikës”. Por, si nisi të merret me politikë?

Së pari, u bë anëtare e AAK-së dhe deputete shumë e zëshme e kësaj parti.

Deputetja e AAK-së, Donika Kada-Bujupi e kujton si shumë të vështirë kohën kur kishte kandiduar për herë të parë si kandidatë për deputete, sepse, sipas saj, një kandidatë nga Istogu e kishte shumë të vështirë të garonte nën logon e një partie tjetër pos LDK-së.

Ajo në atë kohë e kishte numrin 30 dhe pakkush besonte se dikush me numër 30 mund të merr mandatin e deputetit.

Por, ajo e mori atë mandat, madje edhe u bë shumë e zëshme në cilësinë e deputetes.

Megjithatë, as në këtë parti, ku pati privilegje të shumta, nuk u rehatua dhe kaloi në “Vetëvendosje”. Dhe, edhe këtu u bë deputete.

Pastaj, përsëri u kthye në AAK!

Por, në zgjedhjet e fundit parlamentare vendosi të mos garojë për deputete dhe u largua nga jeta politike.

“Ikja nga politika ma ka lehtësuar jetën”, pat deklaruar ajo.

Ndërkohë, nisi të shfaqej si analiste politike, e që i hapi rrugë të kalojë në Presidencën e Kosovës, konkretisht në postin: këshilltare e Presidentes Vjosa Osmani.

**Diturie Haxhaj**

# PSE HESHTIN INTELEKTUALËT TANË?



*“Atdheu nuk vidhet,  
as s’vritet luftëtari i tij!”*  
(Ali Podrimja)

Janë këto vargje të poetit tonë të madh, Ali Podrimja, i cili, në një intervistë, në pyetjen: “Çka u bën të ndjeheni të lumtur?”, qe përgjigjur:

“Më në fund, pas 130 vjetësh, Kosova u pavarësua. Doli në dritë. U fitua liria. Jetojmë të lirë.

Por, shoqëria jonë duhet të jetë e të gjitha shtresave. Nuk bën dikush të ketë e dikush të lypë.

Nuk bën t’i harrojmë eksodet dhe luftërat nëpër të cilat kaluam.

Rruga dikur na shpinte drejt e te shkretëtira e Arabisë...

Të mirën tani duhet ta kërkojmë brenda hapësirës sonë dhe të jemi më solidarë ndaj njëri-tjetrit, përndryshe e keqja mund të trakas në derë!”

S’ka nevojë për koment. Janë fjalë të poetit...

## ZHËNJIMI

Ku, kah i kemi intelektualët tanë? Sikur janë strukur në vete dhe nuk u intereson asgjë tjetër përveç punës së vet, obligimeve të veta ditore e të familjes...

Të rrallë, apo hiq, ata që janë emra, nuk i kemi kyçur në rrjedhat e përditshmërisë sonë, sidomos në jetën politike dhe as në atë kulturore.

Pse?

Fajet i kanë ata apo institucionet shtetërore?

Ata pse nuk duan apo institucionet që nuk i ofrojnë, nuk i ftojnë të japin kontributin e tyre? Të takohesh e të bisedosh me ta e sheh pakënaqësinë e tyre, e sheh zhgënjimin e tyre për të gjitha këto që po ndodhin në mjedisin tonë...

Lajmet s’ të lënë rehat as ditëve të vikendit! Lajmet, informatat e përditshmërisë sonë s’ të lënë rehat as ditëve të vikendit. Ta prishin ditën, thonë shumica e njerëzve. Sepse, Kosova nuk u bë ashtu siç e deshëm, as siç e patëm ëndërruar...

**Gani Dili**

# KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILI

**Redaksia:**

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

**Dizajni:**

Labinot Bërbatovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)

Në ballinë

RESTORANT  
LILIVA

Tavolina 1 Tavolina 2 Tavolina 3 Tavolina 4 Tavolina 5 Tavolina 6 Tavolina 7 Tavolina 8  
Tavolina 9 Tavolina 10 Tavolina 11 Tavolina 12 Tavolina 13 Tavolina 14  
Tavolina 15 Tavolina 16 Tavolina 17 Tavolina 18 Tavolina 19 Tavolina 20 Tavolina 21 Tavolina 22  
Tavolina 23 Tavolina 24 Tavolina 25 Tavolina 26 Tavolina 27 Tavolina 28 Tavolina 29 Tavolina 30  
Tavolina 31 Tavolina 32 Tavolina 33 Tavolina 34 Tavolina 35

# Arbnore Gegollaj,

ylli i fushës së bukurisë  
dhe estetikës, rrëfen  
për rrugën e suksesit



*Emri i saj nuk ka nevojë për prezantim, meqë njihet gjerësisht për punën e shkëlqyer që bënë në fushën e bukurisë dhe të estetikës. Arbnore Gegollaj është estetistja e njohur, puna e së cilës komplimentohet gjerësisht nga klientet e saj. Studio e bukurisë dhe estetikës “Phi Arbnore Gegollaj” në Malishevë, falë shërbimeve cilësore e punës unike, prej kohësh suksesin e ka të garantuar.*





Arbnore Gegollaj, në të gjitha intervistat ka treguar se që në moshë të re ëndërronte për suksesin që e gëzon sot. Ajo nuk u ndal së besuari në ëndrrat dhe veten e saj. Vetëm kështu ia doli të jetë në pikën e dëshiruar.

Në studion profesionale të Arbnores ofrohen një mori shërbimesh, të cilat u vijnë në ndihmë femrave që të shkëlqejnë në çdo kohë. E certifikuar me titujt #Philings #Phibright #Philon dhe #Microneedling, teknika këto shumë të kërkuara në fushën e estetikës, pa dyshim, Arbnora është kryefjala e kësaj fushe. Tek "Phi Arbnore Gegollaj" në Malishevë punohet me teknikat më të avancuara dhe produktet më cilësore, gjë që e bënë diferencën në arritjen e rezultateve.

Përveç ndërhyrjeve në fytyrë, ajo është e profesionalizuar edhe për flokë, ngjyrosje, stilim, grim etj.

Për gjithë suksesin, përveç angazhimit personal në edukim dhe punë, Arbnora thotë për Revistën tonë, "Kosovarja", se mbështetjen më të madhe e ka nga bashkëshorti, me të cilin u martua në moshë shumë të re.

Arbnora tregon për besimin që ai kishte në talentin e saj dhe se si gjithmonë e shtyu në rrugët e suksesit dhe edukimit edhe jashtë kufijve.

## E FEJUAN QËKUR ISHTE 12 VJEÇE!

Interesante është se Arbnoren e fejuan kur ishte 12 vjeçe, në kohën kur shkëlqente në shkollë, kur ishte pjesëmarrëse në kuize diturie dhe kapitene e grupit të shkollës.



Kujton se asaj kohe kishte qarë për fejesën e para-kohshme...

Sot, grua me shumë arritje, e që dikur i ishte mohuar shkollimi i mesëm, për çka ishte ndier tejet keq.

Në moshën 19 vjeçe u bë nënë, ndërkaq në moshën 21 vjeçe për herë të dytë.

Në moshën 24-vjeçare, falë inkurajimit dhe mbështetjes së bashkëshortit, e vijoi shkollimin dhe nuk u ndalë më asnjëherë...

Në moshën 26-vjeçare u bë nënë për herë të tretë, por pa e ndalur rrugëtimin në avancimin profesional si frizere dhe estetiste.

Arbnore Gegollaj e ka kryer shkollën e estetikës në "Phi-Academy", është e certifikuar në CPD dhe Microblading.

## E LUMTUR, E PLOTËSUAR, E PANDALSHME...

Ka ëndërruar gjithmonë t'ia dalë të bëhet dikushi në jetë, të jetë e pavarur dhe me sukses ka arritur t'i jetësojë ëndrrat e saj.

Madje, së shpejti mund ta ketë edhe një studio në Prishtinë, e ndoshta edhe diku tjetër...

Arbnora është e lumtur, e plotësuar dhe nuk ndalet. E falënderon bashkëshortin që ka qenë krahë saj në të gjitha sfidat...

Thotë se ka pasur raste kur ishte para dorëzimit, por që është ngritur edhe më e fortë. E përmbushë shëndeti i mirë, familja e namazi.

Femrat i porosin të mos ndalen, t'i shohin gjërat me pozitivitet dhe të besojnë në sukses.

**Nderim Neziri**



# Ç'thotë nëna e Valonit, i zhdukur pas lufte në Hajkobilë?

*Në moshën më të mirë të jetës, i zhduku Serbia si t'i lëshonte toka: Valon Mehmetin, 13 vjeç, e Fitim Vrajollin, 18 vjeç. Ata u rrëmbyen nga forcat serbe një vit pas lufte, në oborrin e shtëpisë së tyre në fshatin Hajkobilë, pak metra larg kufirit me Serbinë.*

Për të qenë tragjedia edhe më e rëndë, babai i Valonit, Ramizi, u vra me 28 plumba nga serbët, një kilometër këndeje kufirit. Dhe, prej atëherë, zona e brezit kufitar Kosovë-Serbi u boshatis nga banorët. Shtëpitë e fshatit Hajkobilë, përgjatë brezit kufitar me Serbinë, janë boshatisur dhe shkretuar pas lufte, në liri, kur paramilitarët serbë rrëmbyen dy të rinj dhe vranë në pusi Ramiz Mehmetin, punëtor shkolle.

## Ç'THOTË NËNA E VALONIT TË ZHDUKUR?

Shehide Mehmeti, nënë e gjashtë fëmijëve, ka derdhur shumë lot për djalin e vetëm, Valonin, vëllanë e pesë motrave që u zhduk më 31 mars të vitit 2000, në obor-

rin e shtëpisë së tij në Hajkobilë, vetëm pak metra larg kufirit me Serbinë.

Dhe, nëse mijëra nëna me fotografitë e të bijve e të bijave të tyre i kanë kërkuar në protesta, si të zhdukur në luftë, nënë Shehidja e ka kërkuar dhe e kërkon djalin e saj, Valonin, fëmijë të zhdukur në paqe, një vit pas lufte!

E, që dhembja të jetë edhe më e madhe, rasti i djalit të saj dhe nipit, kurrë nuk është shqyrtuar prej askujt dhe është lënë pas dore, me "arsyetimin" se nuk janë zhdukur në luftë...

"Jemi detyruar ta braktisim fshatin dhe të kërkojmë strehë kudo, nga frika se do të futen shkijet në shtëpi dhe të na masakrojnë", pat thënë Shehidja në vitin 2005, në ditën kur e vizitua.

Por, në ditën kur serbët i vranë Valonin e Fitimin, paramilitarët vranë edhe bashkëshortin e saj, Ramizin, duke ia lënë në trup 28 plumba automatiku.

## HAJKOBILLËS NUK I VYEN GJË AS ASFALTI!

Zhdukja e Valonit dhe Fitimit, si dhe vrasja e Ramizit, është edhe një arsye më shumë që sot fshatrave të Gallapit, posaçërisht fshatrave të brezit kufitar, të mos u mjafton as asfaltimi i rrugëve e as shtëpitë e reja, për të qëndruar aty ku ishin me shekuj...

Kështu, nga ai rast, shtëpitë në Hajkobilë kanë mbetur pa banorë...

**Safet Krivaça**

# Një jetë me gazetarë

Teksa mendoja për konceptin e këtij shkrimi, m'u kujtua se dikur, në kohën kur isha fëmijë, në odat me burra më pat rënë të dëgjoj tek thoshin se ai që rri me hoxhë-hoxhë bëhet, ai që rri me më-sues-mësues bëhet. E, kjo i ndodhi edhe personazhit të shkrimit tim, Salih Zekajt, i cili 43 vjet i kaloi me njerëz të penës, të shkrimit, të dijes në revistat tona. Andaj, nuk habit fakti se ai ditë më parë nxori nga shtypi librin publicistik me titull "Dy shekuj të një familjeje me origjinë malësore". Shkurt e shqip: Kush është Salih Zekaj, ish-sekretari i Revistave, i cili punoi 43 vjet me përkushtim dhe bashkëpunoi me shumë njerëz të penës e të dijes?



## Një prezantim tuajin, ju lutem?

- Jam i lindur më 1934 në Fierzë (ish-No-vosellë) të Pejës. Isha bir i një familjeje të madhe 68 anëtarë. Në atë kohë të rralla ishin ato familje që i dërgonin fëmijët në shkollë, sepse botëkuptimi i kohës ishte se shkolla ua prishte fenë... Edhe pse fillova me vonesë në shkollë, me anë të kurseve arrita të kryej kursin e daktilografit, i cili edhe më mundësoi më vonë të gjej punë. Së pari, u punësova në Malishevë, por komuna u shkatërrua dhe personeli i komunës u shpërnda në komuna të tjera. Në Klinë punova pak kohë, por nga aty më larguan shkakun e biografisë familjare, e që nuk ishte në vijë të pushtetit të kohës. Më pas ia mësyva Prishtinës, të cilin qytet nuk e kisha parë asnjëherë në jetë. Një i njohur imi, Sali Sefaj, më tha se me daktilografi mund të gjeja punë në Revistën "Jeta e Re", të cilën aso kohe e drejtonte Esad Mekuli.

## Si ishte takimi i parë me Esad Mekulin?

- Kisha lexuar për Esad Mekulin dhe, thënë të drejtën, kur emri i tij përmendej isha në gjendje të ngrihesha në këmbë. Ishte viti 1966, kohë kur edhe u paraqita në zyrën e Esad Mekulit. Pas një trokitje të lehtë në derë, hyra brenda, në zyrën e tij. Ishte ulur. I ngriti pak syzet dhe më shikoi habitshëm. Shikimi i tij më çorientoi edhe më shumë, aq më keq kur edhe pa një shikim të tillë kisha njëfarë treme. Pasi iu prezantova dhe ia thashë qëllimin e vizitës sime, tundi kokën dhe më tha: "Do të të provojmë nja 20 ditë sa di të daktilografosh". U habita, trupi m'u rrëqeth, sepse nuk e prisja t'më ndalte në punë menjëherë. Të nesërmen, por edhe ditëve të tjera më lavdëronte se punën e bëja si duhet. Por, nuk kaluan as dy javë dhe "dikush" i kishte folur keq për mua. Më ftoi në zyrën e tij. Kur hyra brenda aty ishte edhe Tajar Hatipi, kryeredaktor i Revistës "Pionieri". Tajarin e kisha për herë të parë përballë, sepse deri atëherë e kisha takuar vetëm në korridor. Pasi i përshëndeta, Esadi më tha: "Neve na duhet një njeri me fakultet, letrar". U habita me fjalët e tij, sepse binin ndesh me ato që m'i kishte thënë ditëve të tjera. Ofshana thellë. Dhe, në moment më erdhën fjalët me mllef: Sa herë e kam pasur në dorë "Jetën e Re" ëndërr imja ka qenë t'u takoja, t'u njihja. Por, ja që qenkam mashtruar!"



Në ato çaste ndërhyri Tajari: "Shuj, shuj, mos fol ashtu!", më tha. I zhgënjyer dola nga zyra dhe nuk dija as ku të shkoja...

## Çka tutje?

- Hë, në atë kohë në Revistën "Zani i Rinisë" ishte drejtor Ali Sutaj. Ia mësyna zyrës së tij. Pranoi të dëgjonte hallin tim. Xheladin Potoku, që unë e njihja, i tha: "Drejtor, ky djalë është i anës suaj. Ishte pak ditë në punë në "Jeta e Re" dhe aty e njoha. Unë edhe pak kohë pensionohem, andaj, të lutem, ta pranoni në vendin tim". Aliu më tha: "Ulu, merr makinën e shkrimit dhe fillo të shkruash!". I bëra 6 muaj punë provuese dhe më në fund u shpall konkursi dhe u pranova i rregullt në punë...

## Dhe?

- Ndërkohë, të katër revistat e kohës: "Jeta e Re", "Përparimi", "Zani i Rinisë" dhe "Pionieri" u bashkuan nën një kulm, e mua më caktuan me punë administrate.

## A ke kujtime të tjera me Tajar Hatipin?

- Tajari ishte njeri interesant. Sa herë që dilte Rexhep Hajdari, redaktor teknik, nga zyra, Tajari i thoshte: "A kthehesh?". Sepse, e dinte se Rexhepi më nuk kthehej atë ditë...

## Si ishte njohja me Ali Hadrin?

- Me Ali Hadrin kam shumë kujtime. Punonte shumë. Shumë herë flinte në zyrë. I kam shtypur shumë materiale për Revistën shkencore "Përparimi". Thënë të drejtën, më paguante honorar të mirë.

## Të kthehemi edhe një herë te Ali Sutaj. Thatë se u pranoi në punë. Raporti juaj me Ali Sutajin tutje?

- Njeriu që më ka ndihmuar më së shumti në jetë është Ali Sutaj. Edhe pse ka kohë që ka vdekur e falënderoj shumë. Pa ndihmën e tij nuk do të isha ky që jam sot. Kam kaluar shumë kohë me të: në zyrë, në kafene, në udhëtime... E them me ndërgjegje të plotë se Ali Sutaj ishte "babai" i revistave në gjuhën shqipe në Kosovë. Në kuadër të revistës "Zani i Rinisë", drejtor i së cilës ishte ai, në fillim në formë shtojce, më vonë u bën revista të pavarura: "Kosovarja", "Shkëndija", "Fjala", "BAT-i", "Gazeta e Pionierëve" dhe "Thumbi". Andaj, të gjitha këto revista që i ceka, e që disa dolën me dekada e disa dalin edhe tash, siç është "Kosovarja", janë "pjellë" e Ali Sutajt.

## Di se keni kaluar një kohë të gjatë edhe me Ali Jasiqin. Kur dhe si e njohët?

- Ali Jasiqi, së pari, u punësua në "Rilindje". Shoqërohej me Ali Sutajin. Ishin të pandashëm. Kur të gjitha revistat u bënë nën një kulm, u themelua Ndërmarrja e Revistave e Ali Sutaj u bë drejtor. Ali Sutaj ishte i pazavendësueshëm. Dinte ta vlerësonte njeriun mirë, gazetarin e mirë... Pas tij drejtor vjen Ali Jasiqi. Ai, njëherësh, ishte edhe kryeredaktor i Revistës "Jeta e Re". Në atë kohë mua më emëruan sekretar të ndërmarrjes, meqë ndërkohë kisha kryer edhe shkollën e mesme ekonomike, por edhe Fakultetin Juridik pak më vonë. Edhe me Ali Jasiqin kam pasur një bashkëpunim të ngushtë, i cili bashkëpunim ka zgjatuar deri në vdekjen e tij.

## Sa më kujtohet, drejtor i Revistave ka qenë edhe Rexhep Zogaj, apo jo?

- Po, pas një kohe Ali Jasiqin e ndërruan dhe në vend të tij udhëheqës vjen Rexhep Zogaj, shkrimtar i njohur, por që ishte i kyçur edhe në politikë. Aso kohe ishte anëtar i Komitetit Krahinor të Kosovës. Para se të emërohej Rexhep Zogaj drejtor, Asllan Fazlija, drejtor i "Rilindjes", më tha në telefon: "Organizo tubimin e punëtorëve që të pajtohen për ardhjen e Rexhep Zogajit drejtor. Kjo duhet të jetë punë e kryer!". Pat reagime të disa punëtorëve të revistave, ndërkohë Ali Sutaj, e që ndodhej ulur afër meje në mbledhje, ma shkeli këm-

bën, duke më thënë me zë të ulët: "Ti mos fol asgjë! Le të flasin të tjerët...". Dhe, ndodhi si ndodhi, Rexhep Zogaj u bë drejtor i Revistave dhe në post qëndroi deri në pension. Është meritë e Rexhep Zogajt që të ardhurat personale në kohën e tij si drejtor i kemi pasur mjaft të majme. Por, erdhën edhe vitet e suprimimit të Kushtetutës së Kosovës dhe financimi u ndal, ndërkohë që Rexhep Zogaj shkoi në pension. Postin e drejtor në atë kohë e mori Jonuz Fetahaj.

### **Në këtë kohë vjen edhe te largimi i punëtorëve nga Pallati i Shtypit, a?**

- Jonuz Fetahaj u emërua drejtor i Revistave në kohën më të keqe. Financimi nga shteti u ndal. Na larguan nga Pallati i Shtypit. Mbetëm në rrugë. 6 muaj jemi takuar në kafenenë "Koha", e cila ndodhej afër Pallatit të Shtypit. Më pas arritëm ta merrnim një lokal me qira, pronar i të cilit ishte Alirizai, i ardhur nga Lugina e Preshevës, edhe pse s'kishte kushte pune. Ia bëmë me dije pronarit të shtëpisë se kush jemi dhe se mund të ketë probleme me policinë. Por, ai u shpreh haptazi: "Edhe unë dua të jap kontributin tim për Kosovën". Andaj, me vetorganizim, me gjetjen e donatorëve, e të cilët i falënderoj përzemërsisht, arritëm ta ringjallim "Kosovaren", "Pionierin" dhe "Shkëndijën". Por, shpërndarja e tyre ishte e vështirë, meqë tash duhej ta bënë vetë dhe kudo hasnim në pengesa nga policia serbe. U shtua presioni i policisë serbe ndaj kryeredaktorëve, redaktorëve dhe gazetarëve në maksimum...

### **Ka shumë vite që Gani Dili është kryeredaktor i Revistës "Kosovarja". Në takime të mëhershme keni thënë se Ganiun e njihni që nga koha kur ishte gjimnazist. Më konkretisht?**

- Gani Dili dhe Nexhat Halimi që në kohën kur ishin nxënës gjimnazi sillnin poezi në revistat tona. Ishin të qetë, të prajshëm, por gjithnjë me një droje se a do u botohen poezitë e më vonë edhe shkrimet e ndryshme, kryesisht se ishin të rinj. Mbaj mend si sot Ali Sutaj i priste mirë. Ai edhe ua hapi dyert që ta gjenin veten me shkrime në revistat tona. Dhe, talenti e entuziazmi i Ganiut triumfoi: tash e shumë vite me sukses e boton revistën më të lexuar dhe më të kërkuar shqiptare – "Kosovaren".

### **E, në kohë lufte?**

- Arritëm t'i shpërndanim revistat, edhe pse në gjendje të jashtëzakonshme, më vonë edhe në kohë lufte në Drenicë e Dukagjin deri me fillimin e bombardimeve të NATO-s. Kur filloi lufta masive në Kosovë, më nuk dihej kush ku ishte... Pas lufte u kthyem në Pallat të Shtypit, por çdo gjë ishte shkatërruar...

### **Edhe pas lufte punuat?**

- Po. Punova dhe kontribuova aq sa munda edhe pas lufte, deri në vitin 2009, kur stafi i Revistës "Kosovarja" më bëri një përcjellje të paharruar, siç i ka hije një punëtori shumëvjeçar.

## **IU DOGJËN FOTOGRAFITË DHE REVISTAT, POR JO EDHE KUJTIMET**

Të paktë janë ata gazetarë që nuk kanë pasur bashkëpunim me personazhin e këtij shkrimi. Ka pasur shumë fotografi me ta, me shumëkënd. I ka ruajtur me kujdesin më të madh të gjithë numrat e të gjitha revistave. Në bibliotekën e tij kanë zënë vend pothuajse edhe të gjithë kompletet e shkrimtarëve tanë, por edhe të atyre me renome botërore, e që, mjerisht, ia dogji lufta bashkë me shtëpinë në Fierzë të Pejës. Çdo gjë u bë hi... Por, jo edhe kujtimet e shumta, e që, siç tha: "Po t'i përmendja vetëm një pjesë të tyre do mbusheshin faqet e "Kosovares", madje nuk do të mjaftonin".

### **Çka nuk u tha?**

- Edhe shumëçka... Kjo intervistë do të ishte e mangët po të mos i përmend edhe disa emra të tjerë të gazetarisë, me të cilët kalova një pjesë të jetës: Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Abdyl Bunjaku, Vehbi Kikaj, Jusuf Selimaj, Jak Mita, Qamil Batalli, Hasan Hasani, Daut Demaku, Ymer Shkreli, Nebih Muriqi, Nazmi Rrahmani, Sali Bashota, Milazim Krasniqi, Nafije Latifi, redaktore dhe gazetare e mrekullueshme, Arif Demolli, Demë Topalli dhe shumë të tjerë nga të gjitha viset shqiptare, sepse të gjithë i lidhte puna me mua, qoftë duke i marrë honorarët, qoftë me rishtypjen e materialeve të tyre, të lëshimit të vendimit të vendit të punës, të kërkimit të ndonjë ekzemplari të cilësdo revistë, të marrjes së ndonjë vërtetimi si dëshmi bashkëpunimi apo...

### **Tjetër, për fund?**

- Tërë jetën jam munduar të jem pedant në punë dhe korrekt. E, sa kam arritur e dinë konkretisht ata me të cilët i kalova 43 vjet bashkë...

### **Jetë të gjatë dhe harmoni në familje!**

- Faleminderit! Juve punë të mbarë, të suksesshme dhe gjithë të mirat...

**Isa ILAZI**

**P.S.**

**Sali Zekaj vdiq pak muaj pas kësaj interviste, më 13 tetor 2016.**



**Ulur, nga e majta në të djathtë: Hasan Hasani, Salih Zekaj**  
**Në këmbë, nga e majta në të djathtë: Ali Olloni, Ali Sutaj, Tajar Hatipi, Rrahman Dedaj dhe Jusuf Selimaj**

# Si e la gruaja foshnjën në taksi e vetë iku?!

*“Nuk di ç’nënë është ajo e cila la foshnjën në veturën time dhe, duke u arsyetuar se së shpejti do të kthehet, më nuk u kthye kurrë?!”*

*Mbeta me foshnjën në veturë dhe m’u desh ta thërrisja policinë. Me polici bashkë e kthyem foshnjën në spitalin e lindjes dhe sot e atë ditë nuk di gjë për fatin e foshnjës të lënë në mëshirën e fatit”, thotë taksisti G. H., nga Shkupi, i cili edhe u ballafaqua me këtë problem jo të zakonshëm.*

Jeta e taksistit është me plot ngjarje e ndodhi të ndryshme.

Dhe, se është kështu, flet edhe fakti i ngjarjes që i ndodhi verës së shkuar taksistit G. H., nga Shkupi.

Ai në fakt, i lindur në Shkup, por thotë se familja e tij nga Dukagjini, në rrugë për në Stamboll ndalet në Shkup dhe aty edhe mbesin përgjithmonë.

U takova me G. H. rastësisht, teksa më nevojitej një taksi afër stacionit të autobusëve në Shkup. Nga theksi e kuptova se duhej të ishte kosovar, ose me prejardhje kosovare.

Dhe, ashtu edhe doli...

Më ka rënë të dëgjoj se taksistëve u ndodhin ngjarje të ndryshme. Andaj, edhe insistova t’më tregonte ndonjë ndodhi interesante.

## **NDODHIA INTERESANTE E TAKSISTIT...**

“Moti punoj si taksist. Dal herët në mëngjes, madje edhe në orën 4, sepse

në atë kohë ka udhëtarë që kërkojnë taksi për të shkuar në aeroport.

Gjatë ditës, kryesisht, u bëj shërbim udhëtarëve nëpër Shkup, por nuk janë të rralla rastet kur edhe vij në Prishtinë, madje edhe në Mitrovicë, Gjilan e Pejë.

Verës që shkoi nga baza mora urdhrin të shkoja në Spitalin Shtetëror të Shkupit, që ta dërgoja në vendin ku ajo dëshironte një femër, e cila kishte lindur në spital.

Kur arrita para spitalit, një grua priste në trotuar me foshnjën e saj në dorë. E ndala veturën, dola jashtë dhe ia hapa derën.

Ajo, pasi më përshëndeti, ngadalë hyri në veturë bashkë me foshnjën që e mbante në krah.

Kur u ul, lehtë ia mbylla derën.

Hyra edhe unë në veturë dhe u ula e prisja...

“Ç’pret, pse nuk nisesh?”, më thotë ajo.

“Po e pres tënd burrë. Ndoshta nuk



vonohet", ia ktheva.

"Ç'burrrë pret?! Nuk është këtu pari. As që ka ardhur t'më vizitoj. Pijaneci nuk e di as vetë se ku është... Prandaj, ndize veturën dhe shkojmë prej këtu", më tha si me qortim.

Pasi më tregoi vendin se ku duhej ta dërgoja, e ndeza veturën dhe ia therëm...

E, pak para se të arrinim në vendin e caktuar, mu lut ta ndalja veturën, kinse, në anën tjetër të rrugës, në barnatore kishte për të blerë ushqim për foshnjën. E ndala veturën në një vend parkimi, dola dhe ia hapa derën. Doli ngadalë me foshnjën në krah dhe u nis të trupojë rrugën, meqë në rrugicën që ishim veturat kalonin rrallë andej pari.

"Nuk vonohem shumë", më tha teksa largohej nga unë.

Në ato çaste mendova se dëshironte të ikë se, ndoshta, nuk kishte para të paguajë dhe nuk e kisha fort dert edhe po të mos paguante.

Por, kah mes i rrugës u kthye dhe më tha:

"Foshnjën po e lë në taksi, se po mu marrkan mendtë, meqë ka ditë që nuk kam ecur".

la hapa përsëri derën e veturës dhe ngadalë e la foshnjën dhe u nis përsëri ta trupojë rrugën.

Unë, meqë duhej ta prisja, hyra në veturë dhe fillova t'i dëgjoja lajmet e mesditës. Por, edhe pse lajmet përfunduan, ajo ende nuk u kthye.

Dola nga vetura, shikoja në të gjitha drejtimet, por ajo nuk shihej dot.

Humbi si ta kishte lëshuar toka...

Pas një kohe e thirra policinë. Nuk vonuan dhe erdhën. U tregova se si kishte ndodhur ngjarja. Ata më urdhëruan që bashkë ta kthenim foshnjën në spital, ku edhe e kisha marrë. Në spital e njohën foshnjën në bazë të shenjës që e kishte pasur ende në dorë. Por, për mua nuk përfundoi ngjarja me kaq. Më thanë të shkoja me ta në polici për të dhënë deklaratë se si kishte ndodhur ngjarja.

Edhe aty, pas një pritjeje të gjatë, erdhi një hetues dhe ia tregova në hollësi ngjarjen. Kur dola nga stacioni i policisë terri mbi Shkup veç kishte rënë...

Ishte kjo një ditë imja pa fitim, por me një ngarkesë që edhe sot po më kujtohet si të kishte ndodhur dje...", tha taksisti G. H., në fund të përmblyljes së këtij rrëfimi rrëqethës.

**S. Rama**



## Alketa Gashi-Fazliu Gazetarja me medalje të artë

Shkrimtarja, publicistja e gazetarja Alketa Gashi-Fazliu, jo vetëm që është e dalluar në gazetari, por ajo do të shpërblehet nga UNESCO me Medaljen e Artë "Aleksandri i Madh" në Greqi, me të cilin nderohen personalitete të shquara nga mbarë bota, njerëz dhe organizata për kontributet e tyre nga fusha e shkencës,

letërsisë, politikës, arteve dhe sportit.

Ajo do nderohet për kontributin e saj në fushën e letërsisë, arteve dhe të mirës së përgjithshme.

Ceremonia e dhënies së çmimit mbahet gjatë muajit tetor në Greqi.

Alketa Gashi-Fazliu do të jetë fituesja e edicionit 39 të ndarjes së këtij çmimi.

Radio,  
Lajme, Moti,  
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin  
**Shkabaj** për Android

**Shkabaj**  
Fillo këtu.

[www.shkabaj.net](http://www.shkabaj.net)

ANDROID APP ON  
**Google play**

# Sëmundjet mendore janë më të zakonshme se kanceri!



*Në Ditën Ndërkombëtare të Shëndetit Mendor, më vjen klithja në grykë për të shpërthyer me pezëm e vrer për "faktin" se sëmundja më e zakonshme e kohës sonë nuk është kanceri apo kolesterina. Sëmundjet më të zakonshme sot janë sëmundjet mendore.*

Njerëzit nuk mund të fshehin atakun në zemër. Por, ne i fshehim krizat dhe sfidat tona psikologjike gati nga të gjithë! Me këtë vrer, të mbledhur nga përditshmëria profesionale, takoj njerëz të cilët as që janë të sëmurë dhe as që u mungon diçka materiale, por janë të veshur me petkun e vetëdijshimit e të trishtimit, të cilëve u mungon përqaqimi ynë, u mungon një fjalë jona e thënë me dashuri.

## PSE I BRAKTISIM NJERËZIT?!

Ne, jemi të zënë me jetën tonë, duke mbijetuar çdo ditë, të kapur pas

përgjegjësi dhe detyrave tona, sa që njerëzit, madje as njeriun që ndajmë shtratin me të nuk e "shohim", duke i lënë të vetëm, të braktisur, derisa ata të futën ujërave të errëta të jetës për të gjetur diku dhe dika prehjen e munguar.

Por, ndarazi nga kjo, sot, në ditën e shënimit të shëndetit mendor dhe të "Muajit Rozë", një klithmë tjetër më vjen vërdallë kokës për të shpërthyer dhembjen e prezantimit të gruas shqiptare, që në përplasje të diskutit kulturor e social, vazhdon të jetë e ndrydhur në tytën e mosmirënjohjes, refuzimit, bullizmit dhe stigmatizimit permanent!

## CILA FEMËR NË BOTË ANGAZHOHET MË SHUMË SE SHQIPTARJA?

Po harrojmë se jemi ne, gratë shqiptare, ku vetëm në 24 orë kryejmë obligime familjare aq sa, ndoshta, një grua në Perëndim i planifikon në një javë!

E, ne, pos që jemi bashkëshorte, jemi edhe nënë, bijë, motër, gjyshe, shoqe, amvise, shofere, profesioniste, kolege, pastruese, kuzhinierë, shërbëtores, mësuese, mjeke, nuse tradicionale... Dhe, në të gjitha këto role, pritet nga ne edhe të dukemi bukur, të buzëqeshura, të sjellshme, të urta e pa filozof



fuat shumë, e në mbrëmjen e vonë të jemi edhe të disponuara!

E, kështu, harrojmë veten për të na kujtuar dikush një ditë dhe një muaj në vit siç është edhe "Tetori Rozë", muaji kur duhet të ndërgjegjësohemi për veten tonë. Ndërgjegjësimi kërkon, në radhë të parë, vetëdijesim, jo një ditë e as një muaj, por 365 ditë në vit.

## FILLO TË MENDOSH EDHE PËR VETEN!

Ti, femra shqiptare, që mundohesh për të gjithë, e të mendojnë të gjithë, fillo sot të mendosh edhe për veten, e sidomos për vlerën dhe rolin tënd në familje e shoqëri.

Fillo që sot, meqë ke një arsye, është dita ndërkombëtare e shëndetit mendor!

Ndoshta edhe me një pauzë të vogël 5 minutash!

Se, një veti nuk ndryshon shumë... Disa ndryshojnë pak, e shumë e shumë të tjera ndryshojnë jo vetëm shëndetin mendor, por edhe energjinë dhe dashurinë tënde të pashtershme.

Lëri justifikimet dhe fillo bëje!

Se, po se bëre vetë, nuk do ta bëj askush për ty!

Se, je ti, është dora dhe prehri yt, që përkund dhe ndryshon fatin e njerëzimit!

**Shkëndije Pacolli**

**PRAXIS FÜR  
PSYCHOLOGISCHE  
BERATUNG**  
Shkëndije Berisha Pacolli

☎ +49 152 33 63 07 73  
🌐 info@pacolli-praxis.de  
www.pacolli-praxis.de  
📍 Boschring 6  
56422 Wirges

**BOOM**

# Ludovik Karrica

*50-vjeçari shqiptar  
me trupin më në formë*

*Beqarët  
e estradës*

# Artisti Ludovik Karrica, 50-vjeçari shqiptar me trupin më në formë

*Avangard, luksoz, por edhe klasik. I rafinuar dhe xhentëlmen. Ky është artisti shumë dimensional, Ludovik Karrica.*

*Vallëzon, këndon, luan në filma...*

*Ka prekur suksesin e famën prej vitesh, madje është shfaqur edhe në televizione e filma ndërkombëtarë, por e ka ruajtur modestinë dhe njeriun e mirë brenda vetes.*

*Në të gjitha paraqitjet shfaqet i rrethuar nga luksi.*

*Por, përtej kësaj, çfarë duhet të dimë për Ludovik Karricën?*

*Lexoni në "Boom"...*



**Ludovik, që nga emri e tutje, je personazh ndryshe dhe i veçantë në botën artistike shqiptare. Si ndihesh?**

- Fillimisht, faleminderit! Ndihehem shumë mirë, jam krenar që jam shqiptar dhe reflektoj ndryshe në botën e artit.

**Performancat tua kanë qenë gjithmonë me një dozë të fortë evropianizmi. Kjo të ka ndihmuar në rrugën e suksesit, apo mendon që skena shqiptare ende nuk ishte gati për ty dhe stilin tënd?**

- Po, e vërtetë. Nëse flasim për formimin tim artistik, duhet thënë që stili im gjithmonë ka qenë klasik. Janë përpjekur të sjellë gjëra ndryshe, të rafinuara dhe pa shumë komercialitet brenda. Çfarëdo që kam bërë, e kam bërë me shumë dashuri, pasion dhe art.

Sot skena shqiptare po filtrohet dhe po ecë në hapë me botën. E, kjo është gjë e mirë...

**Cili është projekti që të ka vënë më në qendër të vëmendjes?**

- Sa herë që kam vendosur të shfaqem diku, për një kohë dhe masë të caktuar njerëzish, kam qenë qendra e vëmendjes. Por, natyrisht, asnjëri nuk mund t'u pëlqejë të gjithëve. Isha sensacion kur në një televizion muzikor botëror u ftova të performoja në stilin e Majkëll Xheksanit, pastaj mora pjesë në një film internacional, bëra këngë e videoklipe dhe, kështu, ecën e rrjedhën gjërat.

**Pse bërë një tërheqje nga aktivitetet artistike: muzika, vallëzimi, filmi?**

- Mendoj se çdo artist, në një moment të caktuar, merr kohën e tij për ta shijuar jetën dhe suksesin. Nuk jam tërhequr, thjesht, po pushoj dhe reflektoj. E ardhmja e afërt mund të rezervojë projekte të reja e interesante.

**Pra, do të rikthehesh?**

- Pa dyshim, po. Madje, me gjëra që do të jenë edhe më lart.

**Pa frikë mund të themi që je 50-vjeçari me format më fan-**

**tastike që kemi parë. Ç'thuhet për këtë?**

- Kështu thonë shumë njerëz. Përpiqem të mbahem në formë të mirë fizike, psikike, emocionale dhe të jem në hap me kohën. Çdo gjë do punë dhe mund...

**Cili është sekretit?**

- Do ta quaja dëshirë dhe jo sekret. Përherë kam dashur që në moshën 50-vjeçare të kem një fizik në top-formë dhe të jem i shëndetshëm. Për një kohë shumë të shkurtër i kam humbur 10 kilogramë. Dhe, falë ushtrimeve fizike, për katër muaj kam fizikun e dëshiruar. Transformime të tilla me shumë mund e sakrificë i arrijnë vetëm artistët e Holivudit. E, gjithsesi, me përpjekje dhe vullnet mund t'ia dalë gjithsecili...

**Cilat janë komentet që pranon për fizikun tënd?**

- Më thonë "i çmendur" në kuptimin e mirë të fjalës. Ngado më përcjellin fjalët si: top, shumë mirë, nice, bravo, respekt... Ndryshimi ishte surprizues për të gjithë...

**Si e përshkruan veten me tri fjalë?**

I urtë, i dashur, xhentëlmen. Sipas meje, urtësia nuk është dobësi, por forcë.

**Personi më i dashur për ty?**

- Pa diskutim, nëna.

**Dikujt që do t'i kërkoje falje publike?**

- Askujt. Në këtë pikë jam shumë i qetë.

**Udhëtimi ose eksperiencia e paharruar?**

- Udhëtime dhe eksperiencia kam mjaft, aq sa nuk di se cilën ta veçoj.


Kur isha në pushim njëjavor me shokë dhe fluturonim me aeroplan privat nëpër Evropë, nga një shtet në tjetrin, kam përjetuar një nga përvojat më të paharruara.

Më pëlqente, sepse më dukej që po jetonim në një botë pa kufi e pa kufizime.

**Suksese!**

- Faleminderit!

**N. Neziri**



# Beqarët e estradës

*Të jesh person publik e ta mbash jetën private për vete, nuk është e lehtë, sepse je në syrin e gjithë audiencës. Sidoqoftë, vera e sivjetme i gjeti dhe i la beqarë disa nga artistët e estradës sonë, me apo pa dëshirën e tyre...*



## DON XHONI

Don Xhoni është komentuar shumë herë për jetën e tij private. Por, pas ndarjes nga modelja ruse, reperin e zuri vera single.



## MOZZIK

Mozzik është baba "beqar" tash e sa kohë.

Përtej dëshirës që ka shprehur disa herë për një lidhje dashurie, si duket, edhe kësaj vere, nuk e gjeti shpirtin binjak.

## YLL LIMANI

Këngët e Yll Limanit herë i kanë kënduar dashurisë e herë ndarjes.

Angazhimet e tij në muzikë, si duket, nuk i kanë lënë këngëtarit kohë për një lidhje dashurie, edhe pse nga këngët e tij bëjmë të kuptojmë se Ylli është i lënduar në këtë aspekt.

Si duket, nuk po merr fuqi për lidhje të re?



## ZANFINA ISMAJLI

Zanfina Ismajli është ndër artistet e njohura, e cila jetën private e ka mbajtur pothuajse çdoherë sekret.

Ndonëse nuk është shumë aktive në muzikë, Zanfina edhe me dashuri po rezulton njëjtë!



### DAFINA DAUTI

Mami singël edhe këtë vit është Dafina Dauti. Ajo po e shijon kohën me vajzat e saj, duke mos i lënë hapësirë ndonjë princi në jetën e saj.



### MORENA TARAKU

Morena njihet për jetën luksoze që bën. Udhëtimet, veshja, aksesorët, siç duket, nuk po i ndihmojnë bukuroshes të vendos për fatin e jetës...

### BUTRINT IMERI

Djaloshi simpatik nga Mitrovica, Butrint Imeri, e martoi vëllanë, duke ia lëshuar vetes rendin për martesë.

Por, edhe pse rendin e ka, Butrinti nuk po mund të vendosë për një të dashur, duke bërë që edhe kjo verë kaloi e ai përsëri beqar.



### ENGJËLLUSHA SALIHU

I këndoi dashurisë me shpirt e zemër. Por, në dashuri nuk po mund të vendosë as e vogla e shtëpisë së Shyhrete Behlilit, Engjëllusha.

Edhe kjo verë Engjin e la të lirë si zogu...

### SI TA PËRMBYLLIM KËTË SHKRIM?

Edhe pse beqarë, të gjithë këta yje që i zumë në gojë, po e shfrytëzojnë kohën për të sjellë hite të shumta, për t'i argëtuar ndjekësit e tyre...

E, për jetën e tyre private?

**Denisa Oruqi**



# Çika e Ajetit iku ditën e martesës!

*Në një fshat jo larg Shtimes, ende në oda flitet për atë çka bëri, kur shkoi, kur erdhi, e të tjera të ngjashme. Këtë herë po e japim një muhabet se si fshatarit të tyre u kishte ikur vajza në ditën e martesës...*

Në odën e madhe, brenda krejt me llamperi, pas darke ishin mbledhur burrat e mëhallës dhe i shpraznin gotat me çaj një pas një... Temë e asaj mbrëmje, ku isha edhe unë, ishte ikja e një vajze, para 5 vjetësh, mu në ditën e martesës, e

që aso kohe kishte bërë bujë në këto anë.

E, mu ajo ngjarje atë natë u nxori një debat të bujshëm burrave të asaj ode. Muhabeti u zhvillua si vijon:

"O burra, ka me na leshu toka!", thotë plaku musteqosh, ulur në ballë të odës.

"Pse bre, Hafiz?! Çka ka u ba tash?!", i thotë ai që e ka pranë.

"Çika e Ajetit pat ikë mu në ditën e martesës!", ia kthen Hafizi.

"Qy-qy, po ajo ka qenë moti, bre! Çka të ra në mend tash?!", i thotë ai.

"Më ra në mend se ajo ka qenë e fejume me tjetër kend..."

E, në ditën e martesës, para se të vinin krushqit me e marrë, ja ther te tjetri, që ish kanë në lidhje moti..."

"Qysh asht kanë puna e asaj çike, se nuk kam haber si a kanë?", ndërhyr në bisedë Meta, ulur kah fundi i odës.

"Atë çikë e pat feju Ajeti, për djalin e Jetishit të Drenicës. Por, çika e paska pa pas dikend tjetër.

E, në ditën që ka fillu dasma, çika ka ikë për atë që e ka pas përpara, që e ka dashtë më herët".

"E, qysh ka mujt me ikë në krejt atë tollovi?!".

"Shumë kollaj. Para dite çika ish shku në Shtime te frizerka me i nreq floktë. Djali që e ka marrë e ka prit te lokali, e ka shti në kerr të vet dhe e ka qu në shpi nusen e gatshme..."

"E, ma keq për Ajetin s'ka pas ku me shku. U ka qu fjalë miqve të mos vijjnë me krushq se nuse s'ka!

E, miku s'ka ditë kah me ia majt... Nuk ka dashtë me e ba të madhe dhe u ka thanë burrave se nuk paska qenë ditë e hajrit.

E, pas krejt asaj marre, burrat shkepen, secili kah ka ardh.

Dhe, shukatet ajo punë si të mos ish kanë hiq...

Por, marrja po përmendet edhe tash, mbas sa vjetësh...", e përmbyllë muhabetin plaku mustaqosh, Hafizi.

**S. Rama**





# “Allure Beauty” e rinon aktoren e famshme shqiptare në mënyrë natyrale

*E, kush është ai njeri që nuk do të donte të dukej më i ri sesa moshë reale? Të gjithë duan të duken bukur, freskët, pa shenjat e kohës që ikën dhe nuk ndalet.*

Ta ndalesh kohën, ta kthesh freskinë e sharmin e dikurshëm në mënyrë natyrale, është e mundur dhe këtë e konfirmon transformimi i mahnitshëm i aktore Marjana Kondi.

Marjana Kondi vitet e fundit ka bërë një ndryshim pozitiv, ajo është përtrirë, por nuk i ka ikur aspak origjinalitetit, duke ruajtur mimiken dhe karakteristikat e portretit që e duan aq shumë shqiptarët.


Si ja doli? Si me magji nëpërmjet aparaturës Plexer në “Allure Beauty”. Plexer, pa dhimbje, pa kohë rikuperimi, pa kirurgji, heq çdo lloj shenje në lëkurë, zhdok dhe eliminon rrudhat, shenjat kirurgjikale, shenjat post akne, dëmtime të vjetra lëkure, shenjat e djegies, rigjeneron indet pasi rrit aktivitetin e plazmës (likuid që trupi e prodhon vetë për rigjenerim).

Në “Allure Beauty”, “Plexr” përdoret vetëm për efekt estetik, siç është eliminimi i çdo rrudhe, shenje bishimuluese, bën lifting dhe rigjenerim të lëkurës. Gjithashtu eliminon disa nishane që nuk janë kancerogjenë. “Allure Beauty”, ju jep zgjidhje çdo shqetësimi për shenjat në lëkurën tuaj dhe është klinika e parë estetike në Shqipëri që ka futur përdorimin e “Plexr”. Madje Marjana duket shumë



vite më e re tani që lëkura e saj është e tendosur.

Për të lënë takimin e radhës kontaktoni në faqen e Instagramit @allurebeauty ose në numrin e kontaktit: +355 69 211 1919 Pa rrudha, pa shenja, pa kirurgji plastike, për një lëkurë të bukur vetëm në “Allure Beauty”.



# Si u bëra president i Kosovës dhe ia bëra mat Vuçiçit?!

**T'UA TREGOJ ËNDRRËN DHE MË PAS MË THONI A KAM VEPRUAR MIRË A JO?**

Ishte arritur marrëveshja Prishtinë-Beograd, e duhej të thoshim nga diçka, ne, secili prej politikanëve. Por, ec e fol në Beograd! Dalin liderët e Serbisë dhe flasin se si është arritur marrëveshja dhe, pos të tjerash, thonë se ishte kusht dhe nuk kishin zgjidhje tjetër.

**ÇKA THASHË SI PRESIDENT I KOSOVËS NË BEOGRAD?**

Më vjen rendi edhe mua të them ndonjë fjalë, si president i Kosovës. Dhe, pak si ata e pak si unë, ia kërcas

politikës... Pastaj, vjen koha për pyetje. Më pyet një gazetar serb: "Ju, shqiptarët, a jeni spiunë të Amerikës?"

Ma dha Zoti dhe ia ktheva: "A ka qenë Milosheviqi spiun i Amerikës?"

E, këtë ju duhet ta dini më së miri, në bazë të praktikës që ka ndodhur në Serbi. Ose, ishte dashur të vinte një lider budalla si ai... Ai u ka futur në baltë e ju nuk e keni ditur një gjë të tillë derisa keni sharruar mirë e mirë, pastaj e keni dëbuar nga pallati presidencial për ta nisur për në Hagë... Dhe, të kthehemi në kohë: Së pari, nisi t'i mbyllë shkollat dhe fabrikat në Kosovë dhe t'i largojë njerëzit nga puna për politikë.

U tha, juve, se me largimin e shqiptarëve nga puna, serbëve do ua rrisë rrogat në 2000 marka gjermane në muaj...

E, ju i besuat!

Pastaj, tërë bota e qytetëruar i tha mos e prekë Kosovën, kurse ai vriste çdo ditë shqiptarë...

Tutje, në mesin e asaj arrogance dhe okupimi klasik erdhi Rambuje, në të cilën Milosheviqin e luti bota ta nënshkruante marrëveshjen e tërheqjes së forcave kriminale nga Kosova.

Ai e refuzoi një gjë të tillë dhe, kështu, e humbi Kosovën përgjithmonë...

Tash, shtrohet pyetja: A ka qenë ai spiun i Amerikës? Edhe nëse nuk ka qenë ka punuar për ta, ndoshta edhe pa vetëdije".

S'i i lashë të gjithë gojëhapur?

Të gjithë mbetën gojëhapur dhe zë nuk u dilte nga goja.

Madje, as Vuçiçi nuk e foli asnjë fjalë! Ata heshtnin, e unë, them me vete, ua lëshova...

**S. Murturi**



What's next...

# LAST CALL OF SUMMER

pay 3 nights stay 4

Book now  
+355696041000  
[www.marinabay.al](http://www.marinabay.al)



# Burrin ma ka bërë Zoti dreq!

*Para 10 vjetësh ika nga familja për ta marrë burrin që e kam, sepse familja ime nuk pajtohej të martohesha me të. E, tash dua të iki nga burri, sepse ma ka bërë Zoti dreq!*

Jam nga Gjilani, e martuar para 10 vjetësh, pa pëlqimin e familjes sime. Pas një vjet martesë burri më mori me vete në Zvicër, ku jetonte e punonte. Dhe, jeta jonë nisi si është më së miri... Pas një vjet qëndrimi në Zvicër u punësova në një fabrikë të tekstilit. Orari ishte goxha i gjatë, ama pagesa ishte e mirë.

Por, kur kthehesha në mbrëmje, e lodhur nga puna, më prisnin punët e shtëpisë, meqë vjehrra s'prekte gjë me dorë e vjehri më shumë dilte në parqe të ecte dhe e kalonte një pjesë të mirë të ditës.

## VJEHRRËN E KAM PËR FAQE TË ZEZË!

Thënë shkurt: vjehrrën e kam për moza më keq. Në mëngjes zgjohet herët dhe, në vend se ta bëj kafënë vetë, pret nga unë që t'ia bëj. Më shikon si lyhem e ngjyhem, si mbathem e vishem, si dalë në rrugë, e të tjera të ngjashme, që më bëjnë nervoz. Pra, problemi është se vjehrra më shikon dhe flet keq për mua, e burri nuk më del krahu! Andaj, m'í ka bërë Zoti dreq edhe vjehrrën e edhe burrin dhe nuk po mund t'í shoh me sy!

E, kjo gjë po më dhemb shumë. Sepse, unë e kam lënë familjen për burrë para 10 vjetësh, e ai bëhet sikur në jetën tonë gjërat shkojnë si është më së miri...

## I KAM RËNË PISHMAN QË JAM MARTUAR!

I kam rënë pishman që jam martuar me të, por s'po kam çka me bë, s'dua ta shkatërroj martesën, në radhë të parë për fëmijët që i kam... Por, edhe po t'u tregoj familjes do më thonë vetë e ke marrë e ja pafsh hajrin... Andaj, sado që mendoj të gjej zgjidhje, sado sillem e pështillem, nuk po mund të gjej rrugëdalje... E, deri kur kështu, një Zot e di!

**Verime E., Zvicër**



  
**BREZOVICA**  
HOTEL & SPA

**REZERVO TANI!**

+383 49 30 10 30

STAY ONCE,  
CARRY MEMORIES FOREVER

## A janë shqiptarët të moralshëm?

*“Pas një gjumi të rehatshëm dhe ëndrrave erotike, kafja e mëngjesit do të bënte mrekulli. Por, sikur të mos ishin vajzat... Vajzat që i zgjojnë fantazitë seksuale. Ato sillen rreth e për rreth: majtas, djathtas, para, prapa...”, këto janë fjalë të një kolegut tim, i cili, duke mos gjetur rehati shpirtërore, mundohet të shfryhet me mua.*

### PSE NDIEJMË NEVOJË TË BISEDOJMË PËR SEKS?

Te shumë meshkuj është interesante se ekziston një pasion me një veprim të çuditshëm kur “nuhasin” në afërsi atë për të cilën jetojnë – femrën.

Do të ishte një sfidë e vërtetë një tendencë për përkufizim, se a është ky një lloj i veprimit instinktiv apo veprim tradicional e specifik i rrethit tonë?

Vetëm një gjë e di sigurt: Ekziston një stad ku shumë njerëz bëhen të njëjtë dhe ndajnë mendim proporcional, pavarësisht nga shtresa dhe niveli intelektual. Ky, definitivisht, është “stadi pompoz” dhe nevoja “giciluese”, për të menduar, biseduar dhe diskutuar për seks.

Sepse, kudo në kafene a në ndeja private çdo gjë fillon me bisedën për seks, për të kaluar, pastaj, në biseda të tjera, si, bie fjala, për politikë, jetë të përditshme, e të tjera.

Në librin “Frojdi dhe ndikimi i seksualitetit

në sjelljen njerëzore”, sipas Frojdit, baza për formimin e personalitetit të njeriut është seksualiteti.

Dhe, duke lexuar në vazhdimësi për të, pashë se Frojdi akuzohet nga shumë psikologë, si tejet ekstremë.

Por, sido që të jetë, mendoj se teoria e tij për njerëzit në Kosovë është e tej-kualifikuar dhe ende dyshoj se si Frojdi nuk ishte shqiptar dhe se studimet e tij analitike nuk i kishte kryer në një ordinancë në Kosovë.

### PARA SEKSUALITETIT FEMËROR

### KAPITULLON ÇDO GJË QË ËSHTË MASHKULLORE!

E, filozofi gjerman, Niçe, thoshte: “Mashkulli i vërtetë kërkon dy gjëra: rreziqet dhe lojërat. Prandaj, e kërkon femrën, si lodrën më të rrezikshme”.

Ndryshimet estetike te femrat, pamja bombastike, ecjet që u ngajnë modeli-

meve super-seksi, vetëm sa e rëndojnë gjendjen emocionale te meshkujt.

Dhe, rezultati pason: të bllokohet arsyeja, edukata, fillojnë disa reaksione të çuditshme brenda trupit, truri amortizohet dhe papritur sheh veten para saj, duke i dëgjuar fjalët: “Ec, baju, o laper!”.

Kjo ndodh kur pushtohet nga ekspansioni spontan i instinkteve...

Por, për t’i ikur etiketimit të meshkujve si krijesa pa vetë-kontroll, parimisht këtë çështje mund ta arsyetojmë kështu: Sa më e madhe të jetë nxitja nga jashtë, aq më e vogël është vetëpërmbytja nga brenda. Sido që të jetë, për hir të së vërtetës, duhet të pranojmë se para seksualitetit femëror kapitullon çdo gjë që është mashkullore. Dhe, në fund, jo të gjithë meshkujt janë të pamoralshëm, nga se, po të mos ishte morali për t’i ndrydhur sado pak dëshirat seksuale të shqiptarëve, Kosova nuk do të ishte gjë tjetër veçse një maternitet gjigant.

A. Lara

**KENDA**  
CENTER  
BY SHKENDA DUBOVA

# OFERTË PROMOCIONALE



**TETORI**

Muaji i ndërgjegjësimit ndaj shëndetit

[www.kendacenter.com](http://www.kendacenter.com)

# Pa t'shti në dorë gjinekologu nuk e di çka është kënaqësia!

*Kësaj ngjarje të madhe për mua i ka paraprirë një seri e pandërprerë bisedash me temë seksuale në ordinancën e tij private...*

Gjatë kontrolleve gjinekologjike doktori vazhdimisht më shikonte, sikur donte t'më hante për së gjalli.

Së pari, filloi me prekje provokuese, derisa një ditë nuk u durua dhe më tha: "Oj e poshtër, a nuk po e sheh se po të dua, a?!". Dhe, pa një e pa dy më puthi.

## SI AFROHESHIM GJITHNJË E MË SHUMË?

Herën tjetër, gjatë shpjegimit të rezultatit të analizave, më ishte afruar afër dhe na ishin bashkuar trupat tanë.

Unë po përjetoja një emocion të vërtetë dhe asgjë nuk e kuptoja se çka më thoshte. Në një moment më ka ofruar afër vetes, duke më shtrënguar për beli.

Në kontrollin tjetër, pasi jam zhveshur dhe jam vendosur në shtrat, më ka puthur pa ngurrim dhe pas kontrollit ma la numrin e tij personal, sepse deri atë ditë e kisha vetëm numrin e ordinancës, ku edhe caktoja terminin e kontrollit.

Sa herë që kthehesha nga vizita gjinekologjike im burrë gjithmonë më

thoshte se a isha në kontroll, por asnjëherë nuk më ka pyetur se në cilën ordinancë gjinekologjike isha dhe te cili mjek.

Pas tërë kësaj periudhe, që ishte mjaft interesante për mua si femër, që isha e paprekur dhe e paprovokuar shumë deri atëherë nga meshkuj të tjerë, erdhi momenti final, të cilit nuk i paraprija, por edhe nuk e pengova, por e lejova të shkonte rrjedhshëm... Shkova për kontroll gjinekologjik, sepse dyshoja në infektim, të cilin, edhe sipas sugjerimeve me mjekun, mund ta kisha marrë edhe nga burri, i cili mund ta ketë sjellë deri te unë nga kontakti me ndonjë tjetër femër.

Dhe, pas shumë analizave, dilte vazhdimisht se unë nuk jam e infektuar.

## "DUA TË BËJ SEKS ME TY, QË TA KUPTOSH SE NUK JE E INFEKTUAR!"

Në ditën "kritike" isha e fundit për kontroll. Trokita dhe hyra. Ishte vetëm. Si zakonisht,

i hoqa xhinset, i hoqa edhe brekët dhe mbeta në pjesën e poshtme lakuriq. Pas kontrollit, më tha: "Loçka ime, sot nuk të lëshoj si më parë!".

U shtanga.

Si të vepra?

Pas pak, më tha: "Dua të bëj seks me ty, që ta kuptosh se nuk je e infektuar!".

Filloi t'më puthte në gojë, në vesh, në qafë...

Ma zhveshi këmishën, m'i hoqi gjimnjat dhe filloi t'mi puthte gjinjtë...

Pastaj, më tha: "Nëse ti nuk do seks, unë nuk të prekë, ngase të dashuroj".

Në ato çaste më nuk kisha çka të prisja tjetër. E di se i thashë: "Sot jam e jotja dhe bëj ç'të duash me mua...".

Pas nja gjysmë ore u ngritëm të dy, u veshëm dhe duke e shikuar në sy, i thashë: "Kënaqësi të tillë kurrë në jetë nuk kam përjetuar!".

Dhe, që nga ajo ditë, sa herë që bëj seks me burrë, e imagjinoj doktorin...

E, nuk po më bie keq, sepse edhe po e kënaqi burrin, por edhe veten...

**J., Prizren**





KOMPLEKSI  
CIMA TOWER

AT THE RIGHT TIME,  
**RIGHT PLACE**

+383 49 601 080

CIMA  
Construction

www.cimaks.com



Në çdo hap, një kujtim i ri  
në Kompleksin Dardania.

+383 48 450 888 | [www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)



JETA IME HALLAKAMË...

# Burri më thotë kurvë!

*Nga xhelozia im burrë humbi të gjithë njerëzit me të cilët ishte rritur. Ai mendon se të gjithë më shikojnë mua!*

Isha vetëm 17 vjeçe ku u martova me burrë 30-vjeçar. Isha e re dhe e bukur. Nuk isha vajzë që kisha dalë para martesë përtej fshatit, ku e mbarova shkollën fillore.

Megjithatë, burri filloi të xhelozonte dhe përlehej me fqinjët e kushërinjtë e vet. Kështu, dalëngadalë filluan të na largohen dhe nuk na hynte kush në shtëpi... E, unë vetëm heshtja, edhe pse herë pas herë më bërtiste me fjalët: "Heshtë kurvë! Kurva pa e luajtur bishtin nuk i shkojnë qentë prapa!"

## DJALIN E AXHËS SË TIJ E AKUZONTE SE PO MË SHIKONTE MUA!

Në shtëpi jetonim unë me burrë dhe vëllai i tij me grua e dy fëmijët. Se na u larguan farefisi i burrit as që mërzhitesha, sepse më mjaftonte që në shtëpi

e kisha kunatën dhe me të bisedoja edhe për gjërat më intime.

Por, një ditë erdhi djali i axhës së tij dhe, pa një e pa, dy u ul që t'ia qite kunata një kafe.

Ndërkohë, erdhi im burrë nga pazari dhe nuk i erdhi hiq mirë që e gjeti djalin e axhës së vet te ne, ani pse nuk isha vetëm me të në shtëpi.

Gati sa nuk u çmend duke bërtitur. E, bërtitja e tij bëri që djali i axhës së tij të lë kafënë në gjysmë dhe u qua e shkoi...

Pasi ai doli, mua nuk la gjë pa më thënë: "Pse e latë të hyjë në shtëpi kur nuk jam unë?! Pse i bëtë kafe?!" e të tjera që m'i ngritën nervat.

Dhe, që nga ajo ditë u ndamë. Flinim në dhoma të ndara. Ishte katastrofë ajo jetë...

Kështu jetuam një vit, kur edhe kaluam në banesën që e bleu me kredi nga firma ku punonte.

Tashmë jetonim krejt të vetmuar. Pa askënd tjetër në shtëpi. Madje, as vëllai i tij më nuk vinte të na vizitonte.

Kështu, ai tashmë dukej më i qetë, por jeta ime sa vinte e rëndohej. Sa vinte e bëhej më monotone: pa punë, pa dalje, pa njerëz.

Dhe, duke mos pasur kujt t'i gjuhej në qaftë, rrokej me mua edhe për gjërat më të imta.

## VËLLEZËRIT E MI IA BËN "MAT"!

Dhe, pas një viti në banesë, herën e parë që shkova në gjini, u tregova vëllezërve fill e për pe për jetën time që bëja me burrë. Të nesërmen, pa dijeninë time, vëllezërit e mi i kishin shkuar në banesë dhe i ishin thënë kurrë më të mos më kontaktonte. Por, dy ditë më vonë ai u pa në oborin e shtëpisë sonë dhe u ra në gjunjë vëllezërve të mi, duke u thënë se kurrë më nuk do më shqetësonte, vetëm të shkoja me të dhe të fillonim gjithçka nga fillimi. Dhe, duke menduar se kush do më merr mua po të mbetja vejushë, i luta vëllezërit t'më lejonin të kthehesha te ai...

E, në natën e parë që u ktheva te ai, i thashë se edhe një herë po t'më thotë "kurvë", vetë me duart e mia do ia shti gishtat në fyt. Ai u habit nga fjalët e mia të ashpra, të cilat kurrë nuk ia kisha thënë më parë dhe u betua se do më trajtoj si grua. Kjo bëri që gjërat gradualisht të binin në vend të vet dhe pas një viti më lindi fëmija i parë, vajzë. Kështu, gjërat ndryshuan për të mirë në raportin tonë bashkëshortor. Tash vajza jonë i ka mbushur 15 vjet dhe është rritur pa zhurmë. Ajo nuk di si ka qenë jeta ime me babanë e saj para se të lindte, sepse jam betuar se nuk do ia helmoj jetën kurrë...

V. M.



# DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE

Në një restorant muzike afër Ferizajt...

# Këndonte këngëtarja që i ngjante gruas sime

*Isha një mbrëmje me një shok këngëtar në një restorant muzike në hyrje të Ferizajt. Dhe, teksa këndon këngëtarja, në një moment vjen te tavolina ime dhe më përshëndet butë. Thënë të drejtën, u habita...*

Por, kur erdhi për së dyti, më lë një numër telefoni. Dhe, tërë historinë e shikon një tjetër femër nga tavolina e fytyrës së klonuar dhe ma bën me gisht në shenjë qortimi për numrin...

E ftoj në tavolinë gjithë gaz. I them të mos xhelozojë... Ha-ha-ha, nis gazi ndërmjet nesh...

## GRUAJA IME NË TELEFONIN E KËNGËTARES QË KËNDONTE NË RESTORANT!

Në një moment nxjerr telefonin për të kërkuar një foto dhe më dalin para syve

fotot për vitin e ri 2017, kur kemi dal me gruan në shtëpi dhe shoh se fytyra që i ngjanë asaj fytyre në kafene është fytyra e gruas sime...

Po, si nuk më është kujtuar deri tash?! Si është e mundur të jetoj me atë model fytyre e të mos më kujtohet se është modeli i gruas sime?!

Pas pak, them: "E gjeta! Kjo zonjë qenka modeli i gruas sime! Po, sikur ta marr në shtëpi për kafe do e befasoja gruan..."

Nuk jam i pa mençur, a?! Mund të lavdërohem si ai burri që ishte nisur nga Kaçaniku për në Prishtinë. Qysh në Kaçanik e kishte marr shkrepën të ndezte cigaren dhe me të hyrë në "Veterinik" të Prishtinës shkrepësa i ndezë dhe në atë moment thotë: "Luaje shkrepësa ime, nga Kaçaniku te "Veteriniku"!

Shoh se memoria kishte të drejtë. Nuk do ta ruaj dikë të cilin e sheh çdo ditë. Por, për çudi, mendohem a është ky klon apo baballarët tanë e kanë shëtitur botën e ku dihet ku i del tymi kësaj pune...

## PSE GRUAJA IME GJITHMONË E KA MIRË?!

Dhe, të nesërmen, teksa i mendoj këto gjëra, vjen fqinji im nga Gjermania. Nuk jemi takuar që shumë vjet. Na i bën gruaja kafetë e bashkë me kafe edhe nga një gotë verë.

E, teksa pimë, hapet muhabeti i para shumë vjetëve, para lufte...

Ka qenë më mirë atëherë apo jo?

Për mua dhe fqinjin e mërzitur në kurbet ka qenë më mirë dikur, por për gratë më mirë është tani.

E, gratë, me siguri, e kanë mirë.

Dikur nuk ka ekzistuar shoqëria familjare apo ka qenë shumë e rrallë, thotë fqinji dhe unë pajtohem që e ka mirë.

Por, gruaja nuk pajtohet.

"Nuk po e qëlloni asnjëri", thotë ajo dhe vazhdon: "Dikur ka pasur shoqëri e muhabet shumë më shumë se tash. Kanë ekzistuar kumbaritë dhe ndrikullat me të cilët është bërë muhabeti i hapur dhe mjaft sh lirë.

Kumbara ka pasur të drejtë të hyjë në shtëpi edhe nëse nuk ka qenë aty i zoti i shtëpisë.

Edhe ndrikulla ka pasur të drejtë të shkojë në shtëpi të kumbarës edhe nëse nuk ka qenë e zonja e shtëpisë aty".

Sa mirë i definon gruaja gjërat...

Dhe, mendja më shkon te modeli i fytyrave.

"A mos ka pasur babai i gruas ndonjë kumbar në Shqipëri?", pyes veten. Paskësh mundësi, pra, i them vetes. Nuk qenka krejt rastësi. A mund të jenë motra, ore?!

Ndërkohë, fqinji sheh se jam tretur në mendime...

"Jo-jo, nuk jam humbur, por vërtet isha kah mendoja për kumbaritë që ka pasur një vend dhe shumë me vend e ka gruaja. Bile, paskam mundësi të kem fakte", i them atij.

**S. Rama**

 **anaderm**

Spitali Special për Kirurgji  
Estetike dhe Plastike

GJATË MUAJIT TETOR

*Vizita falas*

Për të gjitha femrat e prekura nga  
kanceri i gjirit



## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### A ka qenë burri im në lidhje me motrën time?

Para dhjetë vjetësh më ke ndihmuar të marthohem me burrin që e kam sot. Më ke thënë se nuk është i rehatshëm dhe kjo ka dal shumë e saktë. Kam pasur probleme të vazhdueshme me burrë, sepse është vonuar shpesh në shtëpi dhe një pjesë të këtyre vonesave e kam ditur pse kanë ndodhur, por nuk i kam bërë të mëdha...

Ato i kam kaluar në heshtje, shpesh edhe duke u grindur me veten, por kam arritur të vij deri këtu me dy fëmijët e mi që i kam si drita.

Nuk jam ndier e fyer deri në momentin kur zbulova se burri po fliste shpesh me motrën time në telefon. Nuk di nëse ka pasur diçka mes tyre, por pse gjithë ato biseda të bëhen, kjo nuk më hyn në kokë... Gradualisht gjërat kanë shkuar deri aty sa mori vesh familja ime dhe u bënë gjërat e mëdha, gati sa nuk u ndamë.

Motra ka qenë e fejuar dhe e ka prishur fejesën!

A ka pasur burri diçka me motrën time dhe a ka ende apo realisht i kanë ndërprerë të gjitha?

### "E humbura"

#### Përgjigje:

*Situatat njerëzore u përngajnë sëmundjeve klinike. Te ju janë ftohur shumë marrëdhëniet me burrin, por gjërat nuk kanë vdekur. Kjo është shpresa më e madhe që mban ti lidhur me të ardhmen.*

*Ato çka kanë ndodhur do të kalojnë dhe nuk do të thyhet asgjë te ju, sepse lidhjen po ua mbajnë fëmijët.*

*Nuk shoh se kanë pasur diçka më shumë se biseda telefonike dhe aty-këtu ndonjë kafe bashkë.*

*Nuk shoh se gjërat kanë kaluar deri në përjetime.*

*Këshilla ime është: Ruaje burrin! Ruaje familjen!*

#### Qetësia po më shëron...

*Zonjë, ju përshëndes nga shpirti. Jam 71-vjeçare. Kam pasur aksident trafiku, por fal Zotit kam shpëtuar, megjithëse pasojat kanë mbetur jo të vogla. Kam qenë*

shumë e shoqërueshme, por tash më shumë e dua vetminë dhe natyrën, ku edhe po e gjej shërimin...

A ka gjë të keqe që jam kandidate në përjetimet e natyrës?

### "Gjyshja"

#### Përgjigje:

*Bajroni, gjatë një udhëtimi të gjatë në natyrë, kishte shkruar: "Është kënaqësi të drunjtohet e pashkelur dhe është një magjepse te bregu i lumit. Kur takohem me natyrën, nuk ndërhyjnë askush të na e prish shoqërinë..."*

*E, Betoveni e Mocarti të gjitha veprat i kanë krijuar nga inspirimi në natyrë. Koordinimi i zërave të zogjve me kafshët dhe lëvizjet e tyre në pyll kanë qenë pjesë e veprave të tyre të famshme.*

*Sepse, natyra është e vetmja zonjë që nuk plaket kurrë, por ajo i shpërblen me shëndet të gjithë ata që e vizitojnë me kujdes dhe duke e shijuar.*

*Andaj, shijoj natyrën, sepse natyra do të të dhurojë shëndet dhe rifreskim të trupit e memories.*

### A do të kem fat me personin që jam në lidhje?

Jam 32-vjeçare, e ndarë nga burri. I kam dy fëmijë. Jam në lidhje me një person nga Gjilani. Kemi biseduar për mundësinë e martesës, sepse atij i ka vdekur gruaja. Të lutem, emrat mos i publiko, por vetëm ma kthe përgjigjen...

A do të kemi martesë?  
A do të shqetësohet familja ime, sepse më thonë se i kam fëmijët dhe nuk duhet të bëjë martesë të re?

**“Gjilani”**

## **Përgjigje:**

*Nuk shoh se ke për të bërë martesë me atë person. Ka shumë gjëra që nuk t'i ka thënë hap-tazi, çiltër. Por, edhe ti ke gjëra që nuk ia ke treguar atij...*

*Shoh se në mes jush ka shumë fshehtësi...*

*Andaj, nuk shoh se mund të keni ndonjë kombinim martesor të lumtur, prandaj mos i hyni kësaj ideje.*

*Ti e do atë, por kjo nuk garanton se fëmijët tu do ta duan atë njeri sikur e imagjinon ti...*

## **Pse vëllezërit nuk janë rehat?**

Jam një zonjë që jetoj jashtë Kosovës. Vendlindja ime është Hasi i Prizrenit. I kam tre vëllezër që nuk janë rehat në shtëpi. Sa herë shkoj bëhet zhurmë e madhe për asgjë. Kushtet i kanë shumë të mira. Punojnë të tre. Gratë e tyre më thonë se gjendja nuk është problematike vetëm kur unë jam aty, por edhe kur nuk jam...

Po dyshojmë se kemi magji... Të lutem, na ndihmo që ta kalojnë këtë problem!

**“Pa shifër”**

## **Përgjigje:**

*Nuk jeni rehat, sepse në dhomën kah rrushi keni probleme. Kontrolloni çdo gjë dhe do të gjeni gjëra të dyshimta, e që janë magji.*

*Posa t'i largoni ato gjëra nga shtëpia, do të rehatoheni dhe vëllezërit më nuk do të kenë probleme si tash...*

## **A do të kem fat për të lindur?**

Përsëritje zonja magjistare, jam 36-vjeçare, jetoj në Kamenicë. Kam pasur tre aborte dhe më qe tre vjet nuk kam mbetur shtatzënë.

A kam shpresa dhe a do të arrij të kem në prehër fëmijën tim?

**“Dua fëmijë”**

## **Përgjigje:**

*Shoh se pas Vitit të Ri do të mbeteni përsëri shtatzënë dhe do të arrish të bëhesh nënë. Muajin e fundit të preferoj ta kalosh në spitalin gjinekologjik, që të mos kesh telashe... Do të të buzëqeshë fati me një vajzë...*

## **A ka gjetur i dashuri im tjetër femër?**

Ju përsëritet nga zemra magjistare, e nderuar! Jam 24-vjeçare, kam kaluar me një djalë një vit. Ai jeton në Zvicër dhe dy herë që ka qenë në pushim kemi folur si të vijnë te fejesa.

Por, që nga gushti i sivjetmë më nuk më flet për fejesë! Nuk di çka po ndodh me të?! A do të fejojemi a po jo?

**“Trimja”**

## **Përgjigje:**

*Nuk po më del se do të keni fejesë. Ai të ka bërë lajka që të kalojë një pjesë të kohës me ty...*

## **PËR LEXUESIT E DIASPORËS**

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

## **Më mendojnë ëndrrat...**

Jam 57-vjeçare, nënë e tre fëmijëve. Kam të kryer Fakultetin Filologjik. Punoj në arsim.

Përballëm që një kohë me ëndrra të këqija. Ma prishin gjumin...

Të lutem, më ndihmo!

**“Tetorja”**

## **Përgjigje:**

*Ëndrrat i referohen një sjelljeje të caktuar të vetëdijes. Nëse gjithnjë mendon keq, edhe ëndrrat do të jenë të kësaj natyre. E, nëse ke forcë ta ruash kontinuitetin e shëndetshëm të të jetuarit, nuk do të biesh në grackën e ëndrrave të këqija. Nëse njeriu ka vetëdije dhe karakter luftues në realitet, atëherë as në ëndërr nuk do të pranojë të pësojë disfatë. Sepse, ndërdija e ruan karakterin e njeriut...*

*Megjithatë, ka diçka që duhet shpjeguar për të të ndihmuar. Je në kohën e menopauzës dhe mundimet që sjell kjo fazë janë të rënda.*

*Duhet t'i bësh një varg testesh të natyrës gjinekologjike që lidhen me gjendjen hormonale dhe këtë më së miri duhet ta shpjegojë eksperti gjinekologjik. Sepse, ka shumë mundësi që ky problem të lidhet me këtë fazë që ke - me menopauzën.*

# Cilën moshë të femrave e ha tregu kosovar?

*Cilën moshë të femrave e ha tregu kosovar dhe cila moshë mbetet në rrugë, pavarësisht shkollimit dhe përvojës?*

*Në këtë temë flasim femrat e punësuar dhe të papunësuar...*

**ATIFETE S., 27 VJEÇE, E PUNËSUAR:**

- Kam gjetur punë në një firmë private dhe më kanë pranuar mirë. Jam menaxhere. Nuk kam pasur kurrfarë kushhtëzimi kur jam paraqitur për punë. E kam kryer Fakultetin Ekonomik, Drejtimi i Marketingut. Punën e zotëroj dhe nuk kam kurrë probleme me shefat e mi. Kjo më bën që të jem e pa konkurrencë. Por, nuk jam e edhe në disponim të mirë, meqë ende nuk e kam kryer obligimin si femër – martesën.

**LIRIDONA A., 24 VJEÇE, E PAPUNË:**

- Ka kohë që konkurroj si në punë shteti, ashtu edhe në firma private, por deri më tash vetëm 6 muaj kam punuar në një

firmë, sepse pas punës praktike nuk ma vazhduan kontratën.

Kudo ku paraqitem, më thonë njëjtë: "Lëre numrin e telefonit, ne të lajmërojmë vetë!". Por, koha po ecë e unë po e kaloj rininë pa punë, e të mos flasim për martesë, sepse s'ke si të gjesh mashkull për martesë kur je e papunë...

**ARTA, NGA PRISHTINA, 25 VJEÇE, E PUNËSUAR:**

- Para 5 vjetësh u interesova për punë në një firmë të vogël. Pronari, kur më pa se isha e re dhe e bukur, më tha: "Nuk kemi nevojë për punë, por për ty ia bëj disi...". Dhe, pasi e shikova drejt në sy, i thashë: "Meqë nuk paske nevojë për punë, s'ka nevojë të bësh kurrfarë lëshimi!". Por, deshi Zoti po ato ditë dëgjova nga një shoqe imja se një firmë e madhe në "Veternik" ishte hapur. U interesova dhe u punësova.

Rrogën e marrë me rregull. Nuk kam probleme. Pak ka vështirësi në udhëtim, meqë autobusi që shkon për në Hajvali nganjëherë mbushet me udhëtarë dhe ta zënë frymën, por veturë timin nuk kam, andaj edhe kjo gjë po kalohet...

**NERSIHE K., 26 VJEÇE, E PAPUNË:**

E kam kryer shkollën e mesme të mjekësisë. Kam aplikuar për punë në shumë

konkurse publike, por kurrënjëherë nuk kam arritur të punësohem.

Të afërmit e mi gjithmonë më kanë thënë se pa e gjetur dikë të njohur nuk do më pranojnë në punë.

E, ku me e gjet atë të njohur?

**B. D., 27 VJEÇE, E PUNËSUAR DHE E MARTUAR:**

- Jam pranuar në punë para 4 vjetësh. Por, gjithmonë përllahemi me burrë, meqë frikësohet se kam lidhje me personin që më ka pranuar në punë.

Im burrë është munduar të ma gjej një vend tjetër të punës, në ndonjë firmë tjetër, por deri më tash nuk ka pasur sukses.

Thënë të drejtën, edhe unë kam dëshirë ta ndërroj vendin e punës, vetëm e vetëm që t'i mbyllet goja tim burri, e unë të fle rehat.

**PËRFUNDIM**

Sado që edhe të punësuarit po e lëshojnë Kosovën për jetë më të mirë në shtetet e Perëndimit, megjithatë është vështirë të sigurohet një vend pune, meqë numri i të papunëve është i madh.

Sepse, vende të reja pune nuk po hapen, por po plotësohen vetëm ato vende që kanë qenë më parë të hapura...

E, kjo nuk e zbutë papunësinë...

**D. H.**





**SHERWOOD**  
Resorts and Hotels



**GREENWOOD**  
Resorts and Hotels



*feel the legend*

**SHERWOOD**  
exclusive Kemer

**SHERWOOD**  
exclusive Lara

**SHERWOOD**  
Dreams Resort



**SHERWOOD**  
Premia Hotel

**GREENWOOD**  
Kemer Resort

**GREENWOOD**  
Suites Resort

[www.sherwoodhotels.com.tr](http://www.sherwoodhotels.com.tr)